



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA
ADRESA NR.2, ASIM ZENELI, NR.10,
NR.6
TEL: 694074311

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME (AKSIONE)

Nr. repertori: 3219

Nr. koleksioni: 2441

Tirane më 18/08/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterine"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021051400265234376



MARRËVESHJE PËR BLERJE KUOTE

Ne Tiranë, sot me datë 19/02/2021 (dymilje e njëzet e një), para meje Notar [Signature], me seli në adresën [Signature], Tiranë, u paraqiten personalisht palet:

A. Shoqëria "Green Coast" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L41329038D, me seli në "Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Katl 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë", përfaqësuar nga administratori Z. Latif Drenofci, shtetas shqiptar, lindur më 28.04.1970, në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035681762 dhe me nr. personal H00428169D, banues në Tiranë (këtu e tutje referuar si "Shitësi");

dhe

B. Shoqëria "Anchor Investments" Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Rruga Ibrahim Rugova, Nd. 40, H. 8, Ap. 45, Njësia Administrative nr. 5, 1019, Tiranë , regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L71421016I, përfaqësuar nga Administratori Z. Albi Shyti, shtetas shqiptar, i lindur më Durrës, në 10.11.1991, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 037338253 dhe me numër personal J11110084P (këtu e tutje referuar si "Blerësi").

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si me poshtë:

vijon:

- Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **1.000 LEK** (një mijë lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Seaside Residence I" sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Rr "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Katl 4, Apartamenti nr. 31, Tiranë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: M11401019T, përfaqësuar nga Administratori Znj. Dafina Keçi ("Kuota").
- Shitësi shtet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e Kuotës të cilësuar këtu më sipër, konkretisht të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **1.000 LEK** (një mijë lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (një përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Seaside Residence I" sh.p.k. dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gëzon si ortak, ja kalon blerësit, i cili pranon t'i blejë, për një çmim të barabartë me **1.200 LEK** (një mijë e dyqind lekë) (këtu e tutje referuar si "Çmimi").
- Blerësi do të paguajë brenda datës ditës se nesërme të firmosjes së kësaj kontrate çmimin e plotë prej **1.200 LEK** në llogarinë bankare të Shitësit me këto të dhëna:
Emri i Bankës: Tirana Bank S.H.A.
Titullari i llogarisë: Green Coast Sh.p.k.
IBAN: AL75 2061 1011 0000 1103 1970 5100
SWIFT: TIRBALTR
- Shitësi në këtë mënyrë deklaron që Kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguroese, kufizim, garanti e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
- Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje dhe në çdo rast me shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të këtë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e Kuotës së mësipërme.

Në çdo rast vetëm pagesa e plotë e Çmimit nga Blerësi është kusht thelbësor për përfitimin e



A2021051400265234376

pronësisë së Kuotës nga Blerësi sipas objektit të kësaj marrëveshje. Me pagesën e plotë të Çmimit nga Blerësit, shitja quhet e kryer dhe Blerësi përfiton pronësinë e Kuotës.

6. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, veprim i cili për të shmangur çdo dyshim do të jetë i vlefshëm dhe ekzekutohet në zyrën e qendrës së biznesit (QKB) vetëm pasi të jetë paguar çmimi i plotë në përputhje me pikat (2), (3) dhe (5) më lart, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi Kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përsa i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të drejtën t'a zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.
7. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar Çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
8. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
9. Palët kontraktore sipas kësaj marrëveshje heqin dorë nga çdo e drejtë e ankimimi të kësaj marrëveshje.
10. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

Kjo Marrëveshje hartohet ne 3(tre) kopje me permbajtje dhe fuqi te njejte ligjore nga te cilat nje kopje ruhet ne arkiven e noterise.

Unë, Noteri, mora autorizimin për përdorimin e të dhënave personale të deklaruesve duke garantuar se të dhënat e përdorura në këtë dokument do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllim të redaktimit të këtij akti, në përputhje rigoroze me ligjin nr. 9887, dt. 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Une Noteri pasi lexova e shpjegova aktin deklaruesve/paleve, konstatova se ajo vjen ne perputhje te plote me qellimin e deklaruesve dhe, pasi deklaruan se e kane kuptuar dhe e pranojne ate e nenshkruan me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe te pavesuar, ne pranine time rregullisht, dhe ne fund une noterja e vertetoj ate sipas ligjit "Per Noterine".

PALËT KONTRAKTORE

Shitësi

Solid Drenofci
Green Coast Sh.p.k.
përfaqësuar nga Z. Latif Drenofci



Blerësi

Albi Shyti
Anchor Investments
sh.p.k.
përfaqësuar nga Z. Albi Shyti



NOTER

ALKET Z MANÇKA





ANCHOR INVESTMENTS

VENDIM I ORTAKUT TË VETËM

Nr. 11, datë 16.08.2021

"Për blerjen e shoqërisë Seaside Residence I sh.p.k."

Shoqëria ANCHOR INVESTMENTS sh.p.k., është person juridik shqiptar, regjistruar në Q.K.B. me NUIS: L714210161, me seli në Tiranë, Rruga "Ibrahim Rugova", Nd. 40, H. 8, Ap. 45, Njësia Administrative nr. 5, 1019.

Kapitali i shoqërisë është 100.000,00 (njëqindmijë/00) lekë dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm, z. Albi Shyti, shtetas shqiptar, lindur në Durrës, më 10.11.1991, me dokument identifikimi letërnjoftim nr. personal J11110084P (100%) i cili është gjithashtu edhe Administrator i shoqërisë.

Sot më datë 07.07.2021, në selinë e shoqërisë mbledhet Ortaku i Vetëm, z. Albi Shyti dhe rendi i ditës është si më poshtë:

1. Diskutimi dhe miratimi i blerjes së 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë Seaside Residence I sh.p.k., Nipt: M11401019T, me seli në Tiranë, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Ap. Nr. 31.
2. Të tjera të mundshme.

Për zhvillimin sa më të suksesshëm të aktivitetit të Shoqërisë, në bazë të Ligjit nr. 9723 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar, akteve të tjera përkatëse ligjore e nënligjore në fuqi si dhe Statutit të shoqërisë, Ortaku i Vetëm,

VENDOSI

1. Miratimin e blerjes së 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë Seaside Residence I sh.p.k. Nipt: M11401019T, me seli në Tiranë, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 4, Ap. Nr. 31.
2. Ngarkimin e administratorit, Z. Albi Shyti, me targa e të drejta të plota për të përfaqësuar Shoqërinë Anchor Investments sh.p.k. për nënshkrimin e të gjitha akteve dhe dokumentacionit të nevojshëm si edhe për kryerjen e të gjitha procedurave të parashikuara nga legjislativi shqiptar në fuqi për qëllimet e këtij vendimi të shoqërisë.

Shoqëria nuk bën ndryshime të tjera dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANCHOR INVESTMENTS sh.p.k.
ORTAKU I VETËM

z. Albi Shyti

